



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 17616 prot.

Lezhë, më: 14-09-2026

PROJEKT-V E N D I M

Nr. -, Datë 14-09, 2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NUMËR 18 DATË 29.02.2024 "PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET".

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", Udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar", pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **5.54 ha**, për vendosjen e Aerogjeneratoreve + **10.7 ha** sipërfaqe pyjore për vendosjen e paneleve diellore (fotovoltaikëve) + **8.78 km** gjatësi rruge + **0.81 km** gjatësi linjë elektrike mund të jepen në përdorim dhe shtrihen në ngastrat/nëngastrat: **4a, 4b, 5, 6a, 6b, 8b, 9, 13b 14b, 15b, 16b, 17b, 18b, 19b, 20b, 21c, 22b, 23a dhe 29** në Ekonominë Pyjore "**Zadrimë**" e shtrirë në Njësinë Administrative Blinisht dhe ngastrat/nëngastrat **78, 79, 80, 81, 82** në Ekonominë Pyjore "**Brinjat e Kreshtës**" e shtrirë në Njësinë Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.
2. Afati për dhënie në përdorim do të jetë deri në 10 vjet në përputhje me Planet e Mbarështimit të dy ekonomive pyjore, me të drejtë rinovimi.

3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse (rrugë auto dhe linja të tensionit elektrik) do të jetë **2797660 (Dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind gjashtëdhjetë)**, lekë e detajuar sipas zërave.
- Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **0.45 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 176000 lekë/ha = 79200 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **3.01 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 143000 lekë/ha = 430430 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **0.65 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lekë/ha = 92950 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **1.43 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Cungishte **X 176000 lekë/ha = 251680 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **4.3 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 143000 lekë/ha = 614900 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **6.4 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lekë/ha = 915200 lekë**.
 - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **2.92 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 35000 lekë/km = 102200 lekë**.
 - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **3.89 km** në kategorinë përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 30000 lekë/km = 116700 lekë**.
 - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **0.82 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 25000 lekë/km = 20500 lekë**.
 - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **1.15 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 50000 lekë/km = 57500 lekë**.
 - Segment linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **0.78 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 145000 lekë/km = 113100 lekë**.
 - Sipërfaqe linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **0.03 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 110000 lekë/km = 3300 lekë**.
4. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nën ligjore në fuqi.
5. Shoqëria përfituese, të paguajë rehabilitimin mjedisor sipas VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor".
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë Lezhë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU

